



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228581

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636738

C.nr.102/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore nga Prishtina, kundër të paditurit A.H nga Vushtrria, rruga ..., aktualisht me vendbanim të panjohur jashtë vendit, me objekt kontesti kthimi i mjeteve nga pasurimi i pasurim pa bazë, me vlerë të kontestit 224.00 euro, jashtë seance me datë 29.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

KONSIDEROHET e tërhequr padia për kthimin e mjeteve nga pasurimi i pa bazë, e datës 06.03.2018, e paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, kundër të paditurit A.H nga Vushtrria, rruga ..., aktualisht me vendbanim të panjohur jashtë vendit, për shkak të mosplotësimit të padisë me adresën e saktë të të paditurit.

**A r s y e t i m**

Paditësja Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, përmes përfaqësueses së saj- Avokatura Shtetërore, me datë 06.03.2018, ka parashtruar padi për kthimin e mjeteve nga pasurimi i pasurim pa bazë në shumën prej 224.00 euro, kundër të paditurit kundër të paditurit A.H nga Vushtrria, rruga ..., aktualisht me vendbanim të panjohur jashtë vendit.

Gjykata me datë 08.04.2024, ka mbajtur seancën përgatitore në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i paditëses, ndërsa ka munguar i padituri A.H, për të cilin është konstatuar se gjendet

jashtë vendit me adresë të panjohur. Me aktvendim gjykata e ka obliguar paditësen, që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimi të tij, ta plotësojë padinë me adresën e saktë të të paditurit, ose të propozojë caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, në të kundërtën gjykata do të veprojë konform nenit 102 par.3 të LPK-së.

Përfaqësuesja e paditëses me parashtrësën e datës 11.04.2024, e pranuar në gjykatë me datë 15.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se nuk ka mundur të siguroj adresën e saktë të të paditurit duke kërkuar lejimin e afatit shtesë lidhur me adresën e tij, por as nuk ka propozuar caktimin e përfaqësuesit përkohshëm për të paditurin.

Marr parasysh faktin se paditësja edhe përkundër kalimit të 20 ditëve, nga dita kur gjykata e ka obliguar për sigurimin e adresës së të paditurit, nuk e ka plotësuar padinë me adresën e saktë të të paditurit, gjykata konform nenit 102 par.3 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.102/18, me datë 29.04.2024

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.